

## Hapat e disiplinës pozitive

Fëmijët kanë nevojë për një mjedis të parashikueshëm, me rregulla të qarta rreth sjelljes së pritshme prej tyre. Shpjegimi në mënyrë të detajuar shmang konfuzitetin sesi nxënësit duhet të veprojnë, duke ulur edhe shfaqjen e sjelljeve agresive dhe veprimeve të tjera të papërshtatshme. Shembulli i mëposhtëm tregon sesi mësuesit, por edhe prindërit në mënyrë të thjeshtë mund të ndjekin hapat e disiplinës pozitive.

1. Përshkruhet sjellja e përshtatshme :

*``Ju lutem, të gjithë qëndroni në qetësi!``*

2. Jepen arsye të qarta të përfitimit të ndjekjes së sjelljes:

*``Do të fillojmë shpjegimin e orës së mësimin dhe është e rëndësishme që në klasë të jetë qetësi, në mënyrë që të dëgjojmë të gjithë. Gjatë kësaj kohe, respektojmë njëri-tjetrin. Mos harroni, trajtojeni shokun dhe shoqen, ashtu siç do që ata/ato të të trajtojnë ty!``*

3. Tregohet rëndësia e sjelljes:

*``E shikoni sa e rëndësishme është që të qëndroni në qetësi? Të gjithë keni mundësi të dëgjoni qartë, të bëni pyetje, të kuptoni dhe të mos shqetësoni njëri tjetrin.``*



#### 4. Përforcimi

Praktikimi i sjelljes së përshtatshme përforcohet vazhdimisht. Format mund të jenë të ndryshme dhe përfshijnë kontaktin me sy, tundjen e kokës, buzëqeshjen, pikë shtesë apo mënyra të tjera falenderimi të vendosura paraprakisht. Kur përdoren shpërblimet, ato duhet që të jenë të menjëhershme dhe të vogla, por të kënaqshme.